



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Visar Basha – Eks. Shqyrtues	13.07.2021	22.07.2021
Fatbardha Rexhaj – Eks. Teknik		

**1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 05.07.2021, OE “Atom Med”, ka parashtruar ankesë me nr: 528/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Made Kos”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me reagens dhe barna”, me nr. të prokurimit: 615-21-2025-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 198,735.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 14.04.2021, data e hapjes së ofertës: 31.05.2021, data e vendimit për dhënien e kontratës: 24.06.2021, data e njoftimit të me letër standarde: 24.06.2021.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2.PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi jone ankimor ka te beje me Vendimin per anulim nga Komuna e Podujeves lidhur me tenderin me titull: Furnizim me reagensa dhe barna, me nr te prokurimit 615-21-2025-1-1-1.

Ne njoftimin per kontrate te dates 30.04.2021, per kete procedure tenderuese sipas FDT vlera e parashikur ka qene :198735.00 euro

Dokumentet te cilat jane kerkuar per te cilat dhe ne jemi duke bere ankese pra jush:

-Kapaciteti Teknik dhe professional,

Pika 2-Autorizimi nga prodhuesi (me informacion nr.prokurimit.nr e kontaktit) (pozicioni 1,2,3)

Pika 4-Kopja e Certifikates CE dhe ISO nga Prodhuesi

Oferta jone ka qene me vleren 143470.00 Euro

Arsyetimi per refuzim te tenderit tone ka qene per:

-Mungon autorizimi nga prodhuesi ose dilet

-Mungon deklarata e prodhuesit te reagensave qe posedon QKMF

Oferta e pretenduesit per kontrate ne vlere prej 186590.00 euro

Me daten 28.06.2021, pran AK ne kemi bere kerkese per Rivlersim te pretenduesit per fitues per arsye sepse gjate analizimit te dokumenteve te derguara nga ofertuesi i shpallur kompania (Grupi i operatorve)GO-Made-Kos&Genius Kosova-Prishtine, kemi hasur ne disa parregullsi lidhur me plotesimin e dokumentacionit te kerkuara s kriter ne FDT.

Kompania e shpallur per produktet 1,2,3 ka plotesuar me te gjitha dokumentacionet ndersa per produktet nga artillulli nr 4-11 nuk ka prezantuar asnje dokumente plotesuaes, tabela e produkteve e gjeni me poshte.

Reagens ASTO (ICHROMA II)	Cope	15,000.00
Reagens CRP (ICHROMA II)	Cope	15,000.00
Reagens D-Dimer (ICHROMA II)	Cope	15,000.00

Epruveta , 1.28 ml (Monitor vital 100)	cope	25,000.00
Amp. Digoxine	Cope	50.00
Amp. Amidoderone	Cope	50.00
Amp. Metoprolol	Cope	50.00
Amp. B-Complex	cope	1,000.00
Amp. Spasmex	Cope	300.00
Sol. NaCl 0.9%, 100 ml	Cope	1,000.00
Sol. Manitol 250 ml, 25%	Cope	100.00

Ne kerkesen per Rivlersim ne kemi kerkuar qe serish te behet vlersim pasi qe as kompania ne fjale nuk ka plotesuar dokumentet e nevojshem siq dhe do ja u prezantojme.

Ne prezantimin e dokumenteve ka ngakuar Iso dhe Ce te Kompanis se vete jo dhe te prodhuesit te produkteve.

Pika 4-Kopja e Certifikates CE dhe ISO nga Prodhuesi eshte kerkuar per te gjitha produktet nuk eshte specifikuar per aritkullin 1,2,3 sikurse pika 2, qe ka qene e dedikuar vetem per produktet nr 1,2,3.

Nese Barnat nuk kerkojne dokumente mbi vertetesin e cilisesn dhe kualitetit te tyre atehere produkti nr 4:

**Epruveta, 1.28 ml (Monitor vital 100)**, eshte product i cili eshte i Patentuar nga prodhuesi dhe posedon dukumentet e cilesis dhe kualifikimit, (CE,ISO), dokumente te cilat mungojne ne oferten e GO Made-Kos& Genius Kosova , per te cilen ne kemi ngritur kete qeshtje ne Rivlersim, por pergjigjeja e AK eshte hedhur si e pa bazuar pasi qe bazohet qe ne dokumentet e kerkuara ne FDT kerkemat jane per poz 1,2,3, gje qe nuk esht e vertet pasi qe dok ISO DHE CE jane kerku per krejt produktet.

Iso te cilat jane prezatuar nga Madekos-Genius Kosova jane Iso -Standarde me keto nr referues: -

**9001**-i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

14001-është nje standard qe i referohet sistemit te menaxhimit te mjedisit, ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

45001- është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 zëvendësoi standardin OHSAS 18001.

13485 - është standardi optimal i pajisjeve mjekësore të industrisë mjekësore, i cili siguron që të gjitha pajisjet mjekësore të përmbushin ligjet e duhura të pajtueshmërisë rregullatore dhe nevojat e klientit.

Disa nga keto standarte jepen per komanin prodhuese e jo dhe per distributonin. Made Kos-Genius jane distributor nuk jane prodhues te produkteve.

Ce Certififata eshte stanard qe lidhet komplet me produktin, per cilesin e produktiti, analizen e produktiti ku eshte standard qe mundet me e mbulu dhe autorizimin pasi lidhet komplet me produktin cilesin dhe garancionin e ti per distribuim dhe perdorim ne labororet mjeksore ne kete rast,dhe nuk ka te beje fare me DISTRIBUTORIN. Keto dokumente mungojne per produktet nga 4-11 per pretenduesine shpallur nga AK.

Vlersimi nga autoriteti duhet te jete i barabart per te gjithë Operatoret ekonomik e jo diskrimnues dhe favozizues siq ka ndodhur ne kete rast.

Nese ne nuk i kemi plotesuar dokumentet per tu shpallur fitues atehere as Made-Kos& Genius Kosova nuk i ka plotesuar, ka mungese te dokumenteve baze per produktet e ofertuatra, nuk mundet me disa te mbulohet e tere pjesa e kerkuar pasi qe eshte favoziruese per kete kompani nga Autoritie kontraktues e qe nuk lejohet me ligjin e prokurimit public.

Vlersimi duhet ne behet sipas kritereve perzgjedhese, qe jane percaktuar, e jo sipas deshiren se zyrtarve te AK.

Ne kerkojme nga ju qe te e vlersoni me kujdsese dhe dokumentet te cilat ne do i bashkangjesim per fituesin dhe ne bae te tyre te i drejtoheni Ak per , vlersim te drejte te procedures dhe anulim te keti aktiviteti i cili eshte komplet nje favorizim edhe ne baze te Çmimit edhe dokumenete.

Andaj, ju si Komunë keni bërë shkelje të nenit 59.4 të LPP-së, sepse Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Po ashtu, edhe shkelje të nenit 41 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, konkretisht paragrafi 41.3, cili paraqet parimet kryesore të vlerësimit të tenderëve sipas LPP-së, dhe njëri ndër ato parime është në pikën 3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.

Automatikisht, në fazën e vlerësimit komisioni i vlerësimit ka rënë ndesh edhe me dispoziten ligjore të RRUOPP, nenin 41.5. pika b.

*“Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:*

*b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;”*

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Të gjitha aktet legjislativë primare dhe sekondare të Prokurimit Publik, e ndalojnë përgatitjen e Dosjes së Tenderit që në një mënyrë favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial. Kjo është e cekur edhe në Nenin 7 të LPP-së. Është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu, Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Po ashtu edhe me nenin 4.4 të RRUOPP ju obligon që Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Lidhur me të gjitha këto parregullësi, ju si autoritet kontraktues, përveç shkeljeve të lartpërmendurs, në mënyrë direkte bëni edhe shkelje tjera të këtyre dispozitave të prokurimit publik, e të cilat janë:

**Neni 1 i LPP-së**, ju obligon që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

**Neni 6 i LPP-së**. Juve si autoritetet kontraktuese, ju obligon që të siguronit që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Dhe jo të veprohet edhe më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, ku ju, si autoritet kontraktues rrezikoni seriozisht të dëmtoni buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për OE të caktuar, atëherë mundësia

është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së.

Neni 4.1 i RRUOPP-së, citon “AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.”

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merr:

### VENDIM

**APROVOHET:** Ankesa e OE Ntsh “AtomMed” si e bazuar

**ANULOHET:** Ky aktivitet i prokurimit, dhe të keshillohet AK për procedure të re me kritere jo deskriminuese dhe favorizuese.

### 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

1. Autorizimi për shitje nga prodhuesi i autorizuar për pajisjet e ofruara-reagensat ( pozicionin 1,2,3).
2. Deklaratë e prodhuesit të reagensave se këta reagensa janë kompatible për aparatet të cilat i disponon QKMF-ja- IChroma II, si dhe operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën e specialistit nga prodhuesi i aparatit që e posedojmë iChroma II i cili do të bëjë aplikimin e testeve në aparat.
3. Certifikata CE dhe ISO nga Prodhuesi.

### 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:  
OE ankues është i përgjegjshëm  
OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm.

### 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

### 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A



## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

### **Pretendimi nr.1**

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, me rastin e publikimit të vendimit për dhenie të ka njoftuar OE-te pjesëmarrës në këto aktivitete të prokurimit edhe me letrat standarde të tenderuesve.

OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Mungon autorizimi nga prodhuesi ose dileri dhe
- Mungon deklaratat e prodhuesit të reagensave që posedon QKMF-ja.

Eksperti shqyrtues, pasi shqyrtimit fillestar të ankesës sqaron se OE ankues, në ankesën e tij të deponuar në OSHP, në asnjë pikë të saj nuk e ka argumentuar ofertën e tij si të përgjegjshme dhe se i njëjti mund të jetë nënshkruar në kontratë.

Në ankesën e tij, pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë kanë të bëjnë kryesisht me ofertën e të rekomanduarit për kontratë dhe kërjt në fund të ankesës se tij prozon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet me arsyetimin se është inicuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se, duke pretenduar se i rekomanduari për kontratë është favorizuar.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se me vet faktin që OE ankues nuk ka arritur të deshmojë se i njëjti i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, bie në kundërshtim me nenin 4.1.26 të LPP-se për faktin se me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP nuk ka arritur të deshmojë interes juridik të Materialit për këto aktivitete të prokurimit.

Poashtu, fakti që i njëjti kërkon të anulohet aktiviteti i prokurimit në fjalë, është në kundërshtim me nenin 108/A Paragrafin 3.1 të LPP-se, ku thuhet: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve **para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Sipas paragrafit të cituar më lart, në rast se një operatore ekonomik, pretendon që ka kritere diskriminuese, atëherë sipas paragrafit 3.1 të nenit 108/A, është dashur të parashtror ankesë në fazën e kritereve.

### **Pretendimi nr.2**

Në vazhdim sa u përket pretendimeve ankimore të OE ankues, lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, eksperti teknik jep këto sqarime:

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se ***"Me datë 28.06.2021, pranë AK në këmbë bërë kërkesë për Rivlersim të pretenduesit për fitues për arsye sepse gjatë analizimit të dokumenteve të dërguara nga ofertuesi i shpallur (grup i operatoreve) Madekos&Genius Kosova- Prishtinë, kemi hasur në disa parregullsi lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar sipas kriterit të FDT-se.***

***Kompania e shpallur për produktet 1,2,3 ka plotësuar me të gjitha dokumentacionet ndërsa për produktet nga artikulli 4-11 nuk ka prezentuar asnjë dokument plotësues, tabelat e produkteve e gjëni me poshtë"***

Eksperti teknik sqaron se autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin në mënyrë të drejtë pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Autorizimin, Deklaratën e prodhuesit të reagensave që posedon QKMF, ISO dhe CE për pozicionet 1,2,3 sipas kërkesës në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Arsyetimi se nuk ka dorëzuar për produktet 4-11 nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit për këto produkte ku poashtu dihet se shumica e këtyre produkteve për të mos thënë të gjitha janë barna dhe këto produkte nuk kanë CE dhe ISO por barnat dihet se duhet të jenë me banderolë sipas ligjeve të AKPPM-se, dhe kërkesa e OE ankues që të keshillohet AK për

procedure te re me kriteret jo diskriminuese dhe favorizuese eshte e pabazuar pasi qe vete OE ankues ka dorezuar oferten duke pranuar te gjitha kushtet e dosjes se tenderit dhe ka rene ndesh me oferten e vet.

**Pra, ky pretendim i OE ankues eshte i pabazuar, per faktin se OE i rekomanduar per kontrate ka plotesuar te gjitha kerkesat e paraqitura nga AK-Komuna e Podujeves ne Dosjen e Tenderit dhe njotimin per kontrate.**

## **8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA PODUJEVË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - ATOM MED.